



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 55 Datë 5.10.2011

PER
MIRATIM SHTESE FONDI PER TRAJTIMIN USHQIMOR TE KLUBIT
SHUMESPORTESH

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim raportin e paraqitur nga Drejtoria e Financës «Për miratim shtese fondi për për trajtimin ushqimor të Klubit Shumësportësh», në zbatim të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë», ligjit nr 10355 datë 2.12.2010 «Për buxhetin e vitit 2011», e ndryshuar, ligjit 10450 datë 14.7.2011 «Për buxhetin e vitit 2011», Udhëzimit nr. 4 datë 27.1.2011 «Për zbatimin e buxhetit 2011», VKB nr. 47 datë 25.8.2011 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë për vitin 2011» si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

VENDOSI

1. Të miratojë shtesën e fondit për trajtimin ushqimor në vlerën 600,000 lekë.
2. Ky fond do të përballohet: 400,000 lekë nga fondi i planifikuar për projektin Zhvillimi i veprimtarive sportive dhe 200,000 lekë nga fondi i planifikuar në buxhetin e vitit 2011 në zërin Rikonstruksion i banjave publike me këtë strukturë buxhetore:

PAKESOHET 00 08140 06 Art. 2310000 - 200,000 lekë

SHTOHET 00 08140 06 Art. 6020000 + 200,000 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Klubi Shumësportësh..
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kryetari

Ilirjan PENDAVINJI